

URDHËR
Nr. 161, datë 26.10.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të nenit 14, të ligjit nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore zëvendësdrejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, z. Dritan Dorda.

2. Kompetencat e deleguara të ushtrohen deri në emërimin e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësdrejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, z. Dritan Dorda.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSSHËM
Taulant Balla